

**Vizita e delegacionit të ZKA së Kosovës në KLSH në kuadër të auditimit paralel IT për sistemet e informacionit të ujësllësave në Tiranë dhe Prishtinë
10-11 nëntor, 2022**

Në kuadër të bashkëpunimit me ZKA-në e Kosovës, në datat 10-11 nëntor, 2022 në mjediset e KLSH-së, u zhvillua takimi i radhës ndërmjet përfaqësuesve të ZKA së Kosovës dhe grupit të auditimit IT të KLSH-së, mbi auditimin paralel që po zhvillohet nga të dy institucionet në sistemet respektive IT të ujësllësave të Tiranës dhe Prishtinës.

Të pranishme në këtë takim ishin dhe Sekretarja e Përgjithshme e KLSH-së, znj. Valbona Gaxha dhe Ndhimës Auditorja e Përgjithshme e ZKA-së, znj. Myrvete Gashi Morina.



Ekipi i auditimit të ZKA-së prezantoi para audituesve të KLSH-së punën e bërë deri më tani mbi përgatitjen e memos studimore në subjektin KRU Prishtinë, ndërsa grupi i auditimit të KLSH-së, prezantoi fazat fillestare të fillimit të projektit të auditimit në subjekt, në funksion të bashkëpunimit dhe auditimit paralel.



Nga prezantimet dhe diskutimet, rezultoi se modulet e përzgjedhura për t'u audituar nga grupet e auditimit, ishin pothuajse të njëjta, edhe pse është punuar në mënyrë të pavarur dhe metodologji të ndryshme të zhvillimit të auditimit IT, çka e bën auditimin dhe më të përafërt në prishtmëritë e konstatimeve.

Nga ekipet e auditimit të të dyja institucioneve, u zhvilluan gjithashtu diskutime për shkëmbimin e ideve dhe përvojave rreth sistemeve të informacionit të përdorura në kompanitë e ujësjellësave KRU Prishtina dhe UKT Tiranë, me qëllim që këto të shërbejnë për vendosjen e fushëveprimit dhe objektivit të auditimit, metodologjinë, si dhe harmonizimin e punës në vazhdimësi, në fazën e terrenit.

Në përmbyllje të aktiviteteve të ditës së parë, u dakordësua se:

- Secili ekip do të përdorë metodologjinë e tij sipas institucionit: për ZKA, auditimi do të zhvillohet sipas Udhëzuesit për auditimet e TI-së GUIDE 5100 dhe procesi do të zhvillohet sipas SNISA 3000 dhe Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit pra procesi/qasja sipas auditimeve të performancës për sistemet e informacionit si dhe aktet ligjore dhe nënligjore të RKS; për KLSH, auditimi do të zhvillohet sipas Manualit të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe atij aktiv, Cobit 4.1, aktet ligjore dhe nënligjore të RSH si dhe metodologjia mbështetur në Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH;
- Ekipet do të përdorin Metodologjinë audituese, e cila praktikohet në institucionet përkatëse dhe bazuar në Manualin e Auditimeve të TI-së i adaptuar nga IDI;
- Objektivit i auditimit do të mbulojë fushat mbi auditimin e Qeverisjes së TI-së, sigurinë e informacionit, planin për vazhdimësinë e proceseve të TI-së, auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit si dhe kontrollet e aplikacioneve.
- Periudha kohore e parashikuar do të jetë fillimi i muajit nëntor 2022-shkurt/mars 2023.

Ekipet do të hartojnë raporte të auditimit të TI-së individuale/të pavarura, ndërsa në fund do të diskutohet rreth një raporti përmblendhës të përbashkët, i cili do të publikohet nga të dyja institucionet, KLSH dhe ZKA.

Në ditën e dytë të vizitës, u zhvillua një takim i përbashkët në Ujësjellës Kanalizime Tiranë, i cili kishte për qëllim njohjen nga afër të kolegëve të ZKA-së me zhvillimet informatike që ky institucion ka kryer deri tani, si dhe ato që planifikon të kryejë, si dhe njohjen me aktivitetet e përbashkëta që zhvillojnë KRU Prishtinë dhe UKT Tiranë mbi teknologjitë IT të zbatuara.



Takimi i radhës ndërmjet grupeve të auditimit, mendohet të zhvillohet në fund shkurtin, 2023.